

AISHE SULA PAÇE

PRURJE TOPONIMORE NGA VENDBANIMET, PETRESH, SHËMHILL, SHTËMAJ, ULËM, FIKAS, SHIJON

Abstrakt

Vjelja në terren dhe shkelja e çdo pëllëmbë toke, për ta parë nga afër lidhjen që mund të ketë toponimi me vendin që përfaqëson, ka qenë qëllimi kryesor i punës sonë. Gjetjet qenë interesante duke shtuar këtu faktin që u ndeshëm edhe me objekte që do të përbënin zbulime arkeologjike nëse do të gërmoheshin.

Gjatë studimit të toponimeve u vu re një dukuri me mjaft interes. Nga vendbanimet e përmendura në titull, vetëm dy prej tyre deklarohen si të krishtera. Bëhet fjalë për fshatrat Fikas dhe Shijon. Tek ky i fundit gjendet edhe Manastiri i njohur i Shën Gjon Vladimirit. Interesantja qëndron në faktin se tek të gjitha vendbanimet e tjera ka plot toponime që i përkasin leksikut të religjionit kristian. Gjenden me shumicë emra shenjtorësh, sigurisht të transformuar nga rrjedha e kohës. Po kështu emri “kisha” del shumë herë si toponim, hasim edhe emrin “kryqi” si të tillë.

Në aspektin etimologjik toponimet, kanë kryesisht origjinë funksionale pra emri është i lidhur me vendin që emërton p.sh. Zabel ~ pyll i vogël rrëzë një kodre ;Maja e sharrës ~ Majë e lartë e zhveshur, me 489m lartësi etj. Siç e përmendëm edhe më lart një vend të veçantë zënë toponimet me origjinë fetare p.sh., Kisha, Kryqi, Mikisha, Shamarina, Shamathe, Shëmërtini, Shijoni, Xhamia, Sheu etj.

Në këndvështrimin fjalëformues, toponimet togfjalësha zënë vendin më të madh. Gjatë punimit kemi analizuar dhe ndarë toponimet në bazë të nënndarjeve të togfjalëshave. Me toponimet që në rrafshin gramatikor do të konsideroheshin si të prejardhura patëm

një punë me interes. Shumë prej toponimeve janë edhe fjalë të parme.

Siç u tha edhe në fillim na ka bërë kuriozë prania e toponimeve me origjinë religjioze kristiane në vende të deklaruara si myslimane. Si të tilla përmendim,

1. Petresh- Shën Pjetri
2. Shamatheu- Shën Mateu
3. Lukshqefën- Shën Stefani
4. Shlliu- Shën Ilia
5. Shamarina- Shën Marina
6. Qafa Shëmërtinit (Shëmërtini-Shën Martini)
7. Shëmhill- Shën Mëhilli
8. Fusha e Shëmitrit (Shëmitri-Shën Dhimitri)
9. Shijoni- Shën Gjoni
10. Përroi Shëmrisë (Shëmrisë-Shën Marisë)
11. Kisha Shënkollit (Shënkolli-Shën Nikolla)
12. Shtëmaj-Shën Thomai

Këto që përmendëm njihen edhe si emra shenjtorësh ndërkohë që ne i kemi gjetur si toponime. Në punimin e plotë kemi edhe plotësim të kuptimit të tyre në lidhje me vendin që emërtojnë. Si p.sh. **Lukshqefën** - Vend në formën e një lugu, përdoret nga fshatarët si arë për mbjelljen e agrumeve. Nga forma gjuhësore që ka kjo fjalë duket që është shumë e vjetër. Në formën e saj të parë do të ketë qenë një **Shën Stefani**.

Shamarina - Arë e vendosur në një pozicion fushor. Shumë pranë me Lukshqefnin. Forma gjuhësore e paraqet si fjalë të vjetër. Në një formë të parme do të ketë qenë **Shën Marina**.

Tipike është edhe mbetja e emrave të objekteve të kultit si xhamia, kisha, kryqi, ndërkohë që gjenden vetëm mbetje të rrënojave të tyre. Si të tilla toponime përmendim. **Mikisha**~Lëndinë. Ndodhet mbi burimin e quajtur Lëzden. Këtu ka ende gjurmë të asaj që dikur mendohet se ka qenë Kishë. **Kisha Shlliut** - Livadh. Emrin e ka marrë nga rrënojat e kishës së Shenjtorit me të njëjtin emër (Shlliu).

Shkëmbi Kishës - Shkëmb i madh që ndodhet poshtë vendit të quajtur Kisha Shlliut.

Shlliu - Arë. Etimologjia e kësaj fjale është e vjetër afro 1500 vjet. Nga përdorimi kjo fjalë është limuar dhe kemi kalimin nga Sant Ilia → Santilia → Shëndëllia → Shënlliu → Shlliu (që kemi sot). **Kyqi Vogël** - Kodër.

Kryqi Madh - Kodër tjetër pas asaj të Kryqit të Vogël.

Në i analizuam toponimet e mbledhura në aspektin etimologjik siç thamë më lart shumica e toponimeve lidhen kuptimisht me vendin që emërtojnë p.sh. **Rruga e Beut** - Rrugë e ndërtuar nga Beu për të vajtur nga rruga kryesore në Therac që siç duket ka qenë vendi i tij i preferuar për të pushuar.

Muri i Beut - Muri që mban Rrugën e Beut të mos shembet nga ana e Fages së Shëmhilit. **Fushat e Ulmës** - Grup lëndinash të vogla që ndodhen në kufirin midis fshatit Ulëm dhe Petresh

Grykshtrig - Pyll shumë i dendur me shkurre. **Lifave** - Lëndina dhe ara të vogla.

Dushku Sulës - Faqe kodre e veshur me dushk.

Përroi i Bubës - Përrua i vogël malor që zbret nga Dushku i Sulës për tek Përroi i Grykës së Lugët.

Kodër Kuvend - Kodër pranë Dushkut të Sulës, pa pyll .

Kroi Hakës - Faqe mali me pyll të dendur .

Shkëmbi Isufit - Shkëmb i lartë që ndodhet mbi Lifave.

Bregu Akshiut - Rrip toke në formë bregu.

Maja Sharrës - Majë e lartë e zhveshur, me 489m lartësi.

Gjatë analizës hasëm edhe fjalë të cilave nuk mundëm t'u japim ndonjë shpjegim kuptimor si të tilla përmendim. **Kurtha** - Qafë rruge. **Gjilkleshja** - Arë, **Gjorgat** - Arë, **Lamkuqmurg** - Pyll, **Poja** - Arë.

Emra vendesh

Gariep, Jemicë, Lafrangë, Larua, Psheq, Murticat, Topore, Jemicë, Masej, Mashaluk, Kurtina.

Një tjetër analizë në të cilën i kemi vendosur toponimet është edhe ajo fjalëformuese. Nga kjo analizë u vu re se numrin më të

madh e përbënin ato toponime që paraqiteshin si togfjalësja të tillë si:

Ruga e Beut	Shkomi (Shkëmbi) Kishës
Kodra Arpes	Kroi Lomit
Qafa gjysmës	Shkomi Shlliut
Qafa Shëmërtinit	Kodra e Fires
Muri i Beut	Loma Sallakut
Fushat e Ulmës	Gropa e Bekos
Cunga Fongut	Gurët e Krypës
Dushku Sulës	Veshti i Bekos
Përroi Bubës	Shkomi Sheut
Komzat e Memës	Lama e Isuf Metës
Kroi Hakës	Kodra Dushkut
Gryka Ullastrës	Planat e Asllanit
Kodër Kuvend	Blini Muftarjet
Gropat e Skiles	Guri i Lopës
Shkëmbi Isufit	Rrapi Bojaxhiut
Kallamët e Hutinit	Hurdha e Bengut
Bregu Akshiut	Kisha Vilës
Ara Muçit	Sheshi i Baçeve
Maja Sharrës	Ara Lekës
Gropa Baltës	Kopshti i Mitanit
Gryka Lugut	Zabeli Reçnit
Shpija Çunvet	Ara e Palit
Përroi Sheut	Përroi Mucit
Faqja Shullonit	Driza Aliut
Arat e Kroit	Përroi Shegëve
Loma Minës	Fusha e Mihajthit
Kopshti Kas (Kopshti Kasës)	Përroi Razakëve
Qafa Paprit	Bregu i Ferrës
Kisha Shlliut	Përroi Kasnekës
Arat e Reçjet	Bishti i Gorgës

Uji te Shegët - (emër+emër në emërore)

Prurje toponimore nga vendbanimet, Petresh, Shëmhill, ...

Uji i Gurit të Bardhë -{togfjalësh i zgjeruar (fjalë+togfjalësh) I Gurit të Bardhë - emër+mbiemër}.

Parvazët e Shkëmbit të Sheut-{Togfjalësh i zgjeruar (fjalë+togfjalësh) E Shkëmbit të Sheut - emër+emër i shquar në gjinore}

Kodra Hakushjet
Xana e Brahimit
Qafa e Kishës
Gropa e Rronjës
Qafa e Shëmërtinit
Ullinj të e Kadiut
Hurdhat e Skënderit
Xana Beqirit
Hurdhat e Bujve
Kisha Shënkollit
Lugu i Cepës
Ara Halilit
Arat e Gjorgës
Fusha e Shëmitrit
Sheshi i Baçeve
Rrapi Kroimshet
Boka e Mullahut
Lama Mursinit
Përroi Gjorgës
Gropa Gubitrit
Përroi Shpatit
Lama Xajës
Kodra Kalicës
Xana Janit

Pylli i Mërseshit
Xana Binjakut
Kodra Fongut
Përroi Urienit
Kodra Barriçit
Përroi Mullinit
Kodra Shijonit
Përroi Mysgjyshit
Ara Paslamës
Përroi Shëmrisë
Burimi i Gjirizit
Përroi Çorrovodës
Gurra e Vakufit
Përroi Kozanit
Primi Ara e Kishës (emër në kallëzore+emër në gjinore)
Ara Gjilalës
Përroi Tëkushës
Ara Pemës
Ara Telës
Ara Gunalës
Përroi Gairepit
Xana Sifit

Toponimet që paraqiten si fjalë të parme zënë gjithashtu vend të gjerë.

Cuqel
Somes
Zabel

Lasqe
Lifave
Çuvern

Plona	Psemes
Molla	Laroi
Driza	Lomë
Marriçi	Bigorri
Preshe	Psheq
Gjorgat	Çairja
Balta	Barkat
Çifligu	Poja
Lëzden	Pusi
Lithia	Therac
Sheu	Kurtina
Gumjari	Lamark
Kroi	Çiflig
Lomi	Lafrangë
Vreshti	Mysgjyshi
Farri	Kusha
Kamëz	Gurra
Loma	Fongu
Tepa	Pyllja
Kunji	Urieni
Gomra	Sharra
Kurtha	Korra
Masej	Çorrovodë
Skariela	Funari
Kurtina	Fikshui
Blini	Kalija
Rrahe	Sonat
Vila	Shpati
Planat	Gariep
Markuq	Topore
Brinjë	Rrethi
Shqita	Çiflig

Kemi bërë edhe një analizë të toponimeve që janë formuar me prejardhje, te cilat i kemi ndarë në:

a) Prejardhja parashtesore

Në analizën tonë, toponime me formim të tillë kemi :

- | | |
|--------------------------------|---------------------------|
| 1. Pasqafe (Pas+qafe) | 4. Mikisha (Mi=mbi+kisha) |
| 2. Nërbregu (Nër =nën +breg-u) | 5. Paslamjet (Pas+lamjet) |
| 3. Nërfushë (Nër=nën+fushë) | 6. Paskunji (Pas+kunji) |

b) Prejardhja prapashtesore.

Me prapashtesën latine –et, (-ettum):

1. Lamkorr-et
2. Malqin-et
3. Qarr-et (e)
4. Xarm-et
5. Kulmak-et

Me prapashtesën e shqipes –as:

1. Shtuf-as
2. Djerr-as
3. Nërmullij-as
4. Shkall-as
5. Driz-as

Me prapashtesa të përziera -esh, -at, -icë, -ishtë:

1. Mërseshi =Mars+esh(prapashtesë e vjetër e gjuhës shqipe)
2. Murtic-at(latine)
3. Ip-ishtë (sllave)
4. Jem-icë (sllave)

c) Prejardhja parashteso-prapashtesore.

1. Nërmullijas [nër(nën)+mulli+as]
2. Përpyllës (për+pyll+ës)

d) Toponime të formuara me anë të përbërjes kemi :

1. Grykshtrig (Gryk+shtrig)
2. Kodërplepet (Kodër+plepet)
3. Majarrush (Maja+rrush)
4. Qafbokë (Qaf+bokë)
5. Veshkazaz (Vesh+kazaz)
6. Kodërdymleq (Kodër+dymleq)
7. Kroimshet (Kroi+mshet)
8. Veshkuqe (Vesh+kuqe)
9. Lamkuqmurg (Lam+kuq+murg)
10. Krykuqe (Kry+Kuqe)
11. Lammoll (Lam+moll)

12. Lamsheu (Lam+sheu)
13. Kodërlugë (Kodër+lugë)
14. Lampsheq (Lam+psheq)
15. Kashtkuqe (Kasht+kuqe)
16. Kodërmarq (Kodër+marq)
17. Lamkishë (Lam+kishë)
18. Kodërmrizit (Kodër+mriz-it)

Në përfundim të këtij punimi na duhet të themi se çështja e etimologjisë së toponimeve mbetet ende e pazgjidhur plotësisht . Edhe pse jemi përpjekur të gjejmë literaturë në lidhje me etimologjinë e toponimeve shqipe , ka qenë e vështirë gjetja e informacionit teorik. Presim me kënaqësi sugjerimet tuaja.

BIBLIOGRAFI

- Agalliu, F., Angoni, E., Demiraj, Sh., Dhrimo, A., Hysa, E., Lafe, E., Likaj, E., *Gramatika e Gjuhës Shqipe 1* (Tiranë 2002).
- Çabej, E., *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe* (pjesa e parë), përg. Seit Mansaku, Brikena Çabej. -Tiranë: Çabej, 2008.
- Çeliku, M., Domi, M., Floqi, S., Mansaku, S., Përnaska, R., Prifti, S., Totoni M., *Gramatika e Gjuhës Shqipe 2* (Tiranë, 2002).
- Demiri, Sh., *Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit (Nga Neoliti deri në 1930)*.
- Jokl, N., *Studime për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip/ përkth. nga origj. Eqerem Çabej; përg. Anila Omari. - Tiranë: Çabej, 2017.*
- Paheshti, P., *Gjeografia e Elbasanit*.
- Riska, A., *Historia e gjuhës shqipe* (cikël leksionesh).
- Zaimi, M., *Kumuria e Elbasanit*.